



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 186/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Imer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vesna Jovanoviq në cilësinë e përfaqësueses së Gragjanska Iniciativa Zajedno Za Opstanak "GIZZO"dega në Partesh, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 25.06.2010, mori këtë:

V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

A R S Y E T I M I

Z. Vesna Jovanoviq në cilësinë e përfaqësueses së Gragjanska Iniciativa Zajedno Za Opstanak "GIZZO"dega në Partesh, ka parashtruar ankesë më datë 21.06.2010, me të cilën pretendon se në VV e fshatit Pasjan-Partesh kanë dalur njerëz të veshur me mica promovuese të Inicativës Qytetare "Zavicaj" në një distancë prej 20 metrash larg këtij VV.

F A K T E T

Më 21 qershor 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Z. Vesna Jovanoviq në cilësinë e përfaqësueses së Gragjanska Iniciativa Zajedno Za Opstanak "GIZZO"dega në Partesh, parashtruesja e ankesës pretendon se ka pasur promovime në VV e Pasjanit-Partesh.

Si kryerës të supozuar parashtruesi i ankesës ka paraqitur Inicativën Qytetare "Zavicaj".

Parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi si provë lidhur me parregullsinë, vetëm se ka cekur me emrin e Doliq Marko si dëshmitar.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Ligji Për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP (Ligji nr 03/L- 073) neni 118.1 dhe Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

118.1 KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në dispozitat e neneve 3.6 pika (c).

KZAP-i konstaton se Ankesa është e pabazuar sepse ajo nuk përmban dëshmi bindëse siç parashihet në nenin 118.1 të LZP-së, gjithashtu ajo nuk përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 3.6 pika b të Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 186/2009 më datën 25.06.2010.



Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala